VENDIM
Nr.10 datë 25.2.2004

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE"

TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Kjo rregullore nxirret në mbështetje e për zbatim të nenit 43 pika c të ligjit 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, nenit 24 të ligjit nr.8365, datë 2.7.1998 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit nr.8610, datë 17.5.2000 “Për parandalimin e pastrimit të parave”, ndryshuar me ligjin nr. 9084, datë 19.6.2003 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8610, datë 17.5.2000 “Për parandalimin e pastrimit të parave” (më poshtë ligji “Për parandalimin e pastrimit të parave”).

Neni 2

Subjekte të kësaj rregulloreje janë të gjitha subjektet që licencohen nga Banka e Shqipërisë në bazë të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të cilat për lehtësi do t’i quajmë “banka”.

Për qëllimet e kësaj rregulloreje termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

- "Autoriteti përgjegjës” konsiderohet Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave.
- "Klientë” konsiderohen të gjithë personat fizikë, juridikë dhe individë që kryejnë të paktën një veprim me bankën.

Neni 3

Qëllimi i kësaj rregulloreje është parandalimi i përdorimit të bankave si rrugë për pastrimin e parave dhe për financimin e terrorizmit, si dhe parandalimi i kryerjes së veprimeve kriminale në fushën ekonomike dhe financiare.

Pastrimi i parave dhe financimi i terrorizmit dëmtojnë reputacionin e bankës në veçanti dhe të të gjithë sistemit bankar. Për parandalimin e këtyre pasojave është e rëndësishme që bankat të zbatojnë vazhdimisht standardet më të larta për ndalimin dhe për gjetjen e rasteve të pastrimit të parave apo të financimit të terrorizmit.

PROCEDURAT E IDENTIFIKIMIT

Neni 4

4.1 Bankat për parandalimin e pastrimit të parave dhe të financimit të terrorizmit, është e rëndësishme të njohin klientët e tyre. Për këtë, bankat hartojnë procedura të brendshme për identifikimin e klientit dhe për njohjen e veprimtarisë së tij ligjore, të përshkruara në udhëzimin “Si të njohim klientin”.

4.2 Bankat kryejnë procedurat e identifikimit sipas nenit 4 të ligjit “Për parandalimin e pastrimit të parave”. Identifikimi i plotë dhe i saktë i klientit është përgjegjësi dhe detyrim i bankës.

Në rast se banka e gjykon të arsyeshme, mund të kërkojë informacion shtesë për identifikimin e klientit. Banka bën identifikimin e klientit të saj kur kryen këto veprime:

a) hapje të llogarisë në bankë;

b) transaksion me bankën mbi kufirin e përcaktuar nga ligji;

c) transaksion nën kufirin e përcaktuar nga ligji, por kur banka ka dyshimet e saj.

4.3 Kur një person (individ) nuk është klient i bankës, por paraqitet për herë të parë përpara saj dhe kërkon të hapë një llogari në bankë, banka bën identifikimin e personit nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, i cili duhet të jetë ligjërisht i njohur, dhe kur ka dyshime, e verifikon paraprakisht duke e ballafaquar atë me një dokument tjetër, si për shembull: një dokument tjetër

bankar, një librezë, një dëshmi automjeti etj., ose duke u konsultuar me ndonjë regjistër të mundshëm publik, pavarësisht nga shuma e transaksionit.

4.4 Kur një person nuk është klient i bankës, por paraqitet për herë të parë përpara saj dhe kërkon të kryejë një transaksion të vetëm (të rastit) me bankën, banka bën identifikimin e personit si në rastin e parashikuar në paragrafin 4.3 të këtij neni, kur shuma e transaksionit është mbi 2 milionë lekë ose kryen disa transaksione brenda ditës shuma e të cilëve e kalon shumën prej 2 milionë lekësh.

4.5 Bankat realizojnë procedurat e regjistrimit, të identifikimit, të verifikimit dhe të raportimit të transaksioneve të klientëve të saj, mbështetur në rregulloret e saj të brendshme të hartuara në mbështetje dhe në zbatim të kësaj rregulloreje, si edhe të udhëzimeve të nxjerra nga Ministria e Financave, autoriteti përgjegjës, në zbatim të ligjit "Për parandalimin e pastrimit të parave" dhe të miratuara nga këshilli drejtues i saj.

Procedurat e brendshme të bankës, të miratuara nga organet përkatëse vendimmarrëse, përcaktojnë dokumentet për identifikimin e klientit dhe për regjistrimin e të dhënave rreth veprimeve financiare të tij, në momentin e hapjes së llogarisë dhe kur kryhen transaksione me bankën.

4.6 Bankat bëjnë verifikimin e identitetit të klientit mbi bazën e dokumenteve zyrtare ligjërisht të njohura. Dokumentet paraqiten në origjinal në bankë dhe banka bën dhe mban fotokopjet e tyre të vulosura prej saj, në dosjen e klientit.

4.7 Bankat ndalohen të hapin llogari anonime, me numra apo me emra fiktivë të klientit.

4.8 Me qëllim identifikimin e plotë të klientit, hapja e një llogarie bankare elektronike (e-banking account) bëhet vetëm me praninë fizike të personit. Të gjitha veprimet e klientit nëpërmjet kësaj llogarie u nënshtrohen kërkesave të pikës 4.3 të kësaj rregulloreje.

4.9 Në rastin e përfaqësimit të klientit me një përfaqësues ligjor (autorizim ligjor), bankat kërkojnë të dhëna për identifikimin e përfaqësuesit ligjor si për çdo rast tjetër të zakonshëm, si dhe autorizimin e tij për të vepruar në emër dhe për llogari të klientit. Bankat mbajnë një fotokopje të autorizimit. Në këtë rast, bankat nuk lejohen të hapin llogarinë pa praninë fizike të urdhëruesit të llogarisë, ndërkohë që veprimet e tjera kryhen nga përfaqësuesi ligjor.

4.10 Për klientët e tyre që kanë llogari ose marrëdhënie të vazhdueshme me bankën, bankat sipas procedurave të tyre të brendshme rifreskojnë periodikisht të dhënat e identifikimit të klientit, si dhe menjëherë, në çdo rast kur ato kanë arsye të besojnë që kushtet e klientit kanë ndryshuar.

4.11 Për identifikimin e klientit person juridik, që paraqitet për herë të parë në bankë, bankat kërkojnë minimalisht informacion të bazuar në këto dokumente për të bërë identifikimin e tij:

a) vendimin e regjistrimit në gjykatë dhe statutin e personit juridik;

b) listën e personave që kanë pjesëmarrje influencuese ose kontrolli të personit juridik;

c) listën e drejtuesve kryesorë të personit juridik;

d) listën e personave që kanë autoritetin për të vepruar për llogari të personit, kur ata janë të ndryshëm;

e) lejen e ushtrimit të veprimtarisë nga organet përkatëse.

Në momentin e hapjes së llogarisë, banka bën identifikimin e drejtuesve kryesorë të personit juridik, sipas kërkesave të pikës "a" të nenit 4 të ligjit "Për parandalimin e pastrimit të parave".

4.12 Në rastet kur personi nuk përmbush kërkesat e bankës sipas ligjit, për identifikimin e tij, banka refuzon hapjen e llogarisë së klientit dhe nuk hyn në marrëdhënie biznesi, derisa të plotësohen kërkesat për identifikimin e tij, si dhe njofton autoritetin përgjegjës sipas rastit.

4.13 Në rast se edhe pas ndonjë veprimi banka konstaton ose provon identitetin fiktiv, ajo ndërpret menjëherë çdo veprim me klientin dhe njofton autoritetin përgjegjës.

4.14 Bankat nuk kryejnë veprime financiare, nëse klienti nuk deklaron burimin e shumës së parave të transaksionit për vlerat e përcaktuara në ligj dhe/ose identitetin e përfituesit.

PROCEDURAT E REGJISTRIMIT

Neni 5

5.1 Bankat regjistrojnë të dhëna të përcaktuara për çdo klient që kryen veprime financiare, në emër të tij ose për llogari të të tretëve, në ose mbi shumën prej 2 milionë lekësh ose kundërvlerën në monedha të tjera të huaja.

Bankat regjistrojnë dhe bëjnë raportimin pranë autoritetit përgjegjës për çdo veprim financiar

edhe nënvlerën e caktuar më lart, në rastet kur ka të dhëna, bazuar në fakte e rrethana konkrete apo në dyshime për pastrim parash ose për financim të terrorizmit. Informacioni i grumbulluar duhet t'u krijojë mundësinë autoriteteve të ringrenë ciklin e plotë të transaksionit. Ky informacion duhet të sigurohet nga banka nëpërmjet identifikimit të klientit.

Regjistrimi i të dhënave bëhet sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti përgjegjës.

5.2 Banka ka të drejtë që për çdo transaksion të kërkojë sqarime dhe të bëjë verifikime për të dalë qartë burimi i krijimit të parave që përdoren për transaksionin dhe përfituesin e këtij transaksioni, si dhe të evidentojë këto burime.

AFATI I RUAJTJES SË DOKUMENTACIONIT

Neni 6

6.1 Bankat ruajnë dokumentacionin e paraqitur për identifikimin e klientit që nga hapja e llogarisë dhe ndryshimet e tij gjatë kohës, për një periudhë jo më pak se 5 vjet nga dita e ndërprerjes së marrëdhënieve të klientit me bankën (mbyllja e llogarisë).

6.2 Bankat ruajnë regjistrimet e të dhënave dhe dokumentacionin për çdo transaksion, përfshirë edhe të dhëna për klientin, pavarësisht që kryhet për llogari të tij ose për llogari të të tretëve, së bashku me të gjithë dokumentacionin justifikues, për shumat në ose mbi 2 milionë lekë ose shuma ekuivalente në monedhë të huaj, për një periudhë jo më pak se 5 vjet nga data e kryerjes së veprimit financiar.

6.3 Bankat ruajnë regjistrimet e të dhënave dhe dokumentacionin për çdo transaksion, përfshirë edhe të dhëna për klientin, pavarësisht që kryhet për llogari të tij ose për llogari të të tretëve, së bashku me të gjithë dokumentacionin justifikues, për shumat edhe nën 2 milionë lekë ose shuma ekuivalente në monedhë të huaj, për një periudhë jo më pak se 5 vjet nga data e kryerjes së veprimit financiar, kur ekzistojnë elemente të dyshimit, për të cilat banka ka raportuar edhe tek autoriteti përgjegjës.

RAPORTIMI TEK AUTORITETI PËRGJEGJËS

Neni 7

7.1 Bankat hartojnë procedurat e tyre të brendshme për raportimin e transaksioneve të dyshimta tek autoriteti përgjegjës.

7.2 Kur një banke i kërkohet kryerja e një transaksioni nga një klient i saj ose nga një person tjetër dhe banka ka arsye të besojë ose të dyshojë se një transaksion mund të jetë i përfshirë në pastrim parash ose në financim të terrorizmit, ajo duhet menjëherë të njoftojë autoritetin përgjegjës sipas procedurave të përcaktuara në udhëzimet e brendshme të bankës dhe kërkon prej tij udhëzimet përkatëse për veprim të mëtejshëm, kryerjen ose jo të transaksionit.

Banka ka detyrimin të refuzojë kryerjen e transaksionit kur kjo i kërkohet nga autoriteti përgjegjës.

7.3 Në çdo rast, kur një bankë ka arsye të besojë ose të dyshojë që një transaksion i kryer mund të jetë i përfshirë në pastrim parash ose në financim të terrorizmit, ajo duhet të bëjë regjistrimin e të gjithë informacionit dhe të njoftojë autoritetin përgjegjës menjëherë dhe në çdo rast jo më vonë se pas 72 orëve, sipas procedurave të raportimit të caktuara nga autoriteti përgjegjës.

Bankat një kopje të këtij njoftimi e dërgojnë edhe në Bankën e Shqipërisë (Departamenti i mbikëqyrjes).

7.4 Bankat duhet menjëherë të njoftojnë autoritetin përgjegjës në çdo rast kur kanë informacion ose dyshime që një transaksion ka si burim, rrjedh ose është përdorur, si dhe synohet të përdoret për të rritur mbështetjen, për të lehtësuar, për të ruajtur, për të nxitur ose për të fshehur aktet terroriste ose financimin e terrorizmit ose kryerjen e veprimtarive kriminale në fushën ekonomike dhe financiare.

7.5 Bankat nuk kryejnë veprime financiare kur kanë arsye ose prova që i bëjnë të besojnë se ato janë të lidhura me pastrim parash. Bankat në këto raste njoftojnë menjëherë autoritetin përgjegjës dhe në çdo rast jo më vonë se 72 orë.

7.6 Bankat hartojnë procedura të brendshme lidhur me transaksionet e dyshimta. Personat përgjegjës në drejtoritë qendrore të bankave, në degët e agjencitë e bankave shqyrtojnë njoftimet e punonjësve që kanë identifikuar një transaksion të dyshimtë dhe vendosin për të njoftuar ose jo autoritetin përgjegjës jo më vonë se 72 orë pas identifikimit të transaksionit, sipas procedurave të përcaktuara nga autoriteti përgjegjës.

7.7 Bankat duhet të sigurojnë çdo informacion shtesë që mund t'i duhet autoritetit përgjegjës, të cilin vetëm administratorët e autorizuar të bankës kanë të drejtë ta japim.

7.8 Bankat raportojnë tek autoriteti përgjegjës për të gjitha rastet e një ose disa veprimeve financiare në *cash* dhe/ose të transfertave të fondeve për shumat mbi 20 milionë lekë ose kundërvlerën në monedha të tjera të huaja, sipas "formularit të raportimit", të përgatitur nga autoriteti përgjegjës.

7.9 Bankat për transfertat elektronike që marrin, duhet të sigurojnë informacione lidhur me dërguesin e parave (emrin, adresën dhe numrin e llogarisë); në rast se ky informacion nuk është i plotë, atëherë njoftohet autoriteti përgjegjës.[1]

7.10 Bankat njoftojnë autoritetin përgjegjës për të gjitha rastet e dyshimta për pastrim parash dhe për veprimet mbi shumat e parashikuara në pikën 2 të nenit 5 të ligjit "Për parandalimin e pastrimit të parave" dhe ndryshimet e tij në veprimtaritë bankare, të paraqitura në aneksin 2 të kësaj rregulloreje.

7.11 Bankat duhet të kenë politika dhe procedura të mjaftueshme që i adresohen çdo rreziku të veçantë, i cili shoqëron transaksionet dhe marrëdhëniet e biznesit që realizohen edhe pa praninë fizike të klientit ose të përfaqësuesit të tij.

STRUKTURAT PËRKATËSE BANKARE DHE PËRGJEGJËSITË

Neni 8

8.1 Bankat krijojnë strukturën dhe infrastrukturën e nevojshme për parandalimin e përdorimit të tyre si rrugë për pastrimin e parave, të rrjedhura nga aktivitete të paligjshme, sipas nenit 7 të ligjit "Për parandalimin e pastrimit të parave".

8.2 Bankat caktojnë një procedurë të brendshme për evidentimin dhe për sinjalizimin e operacioneve të dyshimta, të formalizuar në rregulloret e brendshme të tyre, të miratuara nga këshilli drejtues i bankës, që i është bërë e njohur gjithë personelit të bankës.

8.3. Degët e bankave që veprojnë në Republikën e Shqipërisë regjistrojnë të gjitha veprimet financiare të çdo klienti për shumat në ose mbi 2 milionë lekë ose kundërvlerën në monedha të tjera të huaja. Ndërsa drejtoria e përgjithshme mban të gjitha raportimet e bëra nga degët e bankës, si dhe mban të dhëna të përmbledhura për të gjithë rrjetin e saj në Shqipëri.

8.4 Bankat hartojnë politika dhe procedura të brendshme të tyre për efekt të parandalimit të pastrimit të parave, si edhe një program vjetor të trajnimit të nëpunësve të tyre për këtë çështje. Kopje të këtyre dokumenteve, si edhe të ndryshimeve të tyre dërgohen në Bankën e Shqipërisë menjëherë pas miratimit të tyre.

8.5 Bankat duhet të informojnë periodikisht punonjësit e tyre lidhur me ndryshimin e procedurave ligjore për dënimin e aktit kriminal të parandalimit të pastrimit të parave dhe për detyrimet e tyre në zbatim të këtyre ndryshimeve.

Neni 9

9.1 Bankat caktojnë një ose disa persona përgjegjës për të siguruar që kanë realizuar detyrimet e tyre për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit. Këta persona përgjegjës duhet të kenë autoritetin e mjaftueshëm dhe eksperiencën e nevojshme për të kryer këtë detyrë. Personat përgjegjës do të mbajnë kontakte të vazhdueshme me autoritetin përgjegjës dhe me Bankën e Shqipërisë.

9.2 Bankat njoftojnë autoritetin përgjegjës dhe Bankën e Shqipërisë për emrin e personit të kontaktit, përgjegjës për raportimet, duke u angazhuar për zbatimin e detyrimit të bankës për të luftuar

[1] Dokumentacioni i plotë identifikues të shoqërojë transfertën në etapat e lëvizjes së saj nga dërguesi i parë te përftuesi i fundit.

pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

Neni 10

Banka krijon dhe mban një bazë të dhënash për klientelën, të përbërë nga karakteristikat ekonomike dhe financiare të tyre, që t'i shërbejë punonjësit të saj për të vlerësuar dhe për të identifikuar transaksionet, potencialisht të lidhura me veprimtari të paligjshme.

Neni 11

Banka u kushton vëmendje rasteve kur degë të veçanta kërkojnë furnizim në *cash* ose rasteve që përfaqësojnë transaksione në *cash* për vlefta që i kalojnë shumë kërkesat e zakonshme, në bazë të karakteristikave të zonës dhe të klientelës që i shërbehet.

Bankat hartojnë politika për shtimin e transaksioneve nëpërmjet veprimeve në llogari, për futjen e produkteve të reja bankare si instrumenteve të pagesës që shtojnë interesin e publikut për të qenë klientë të bankës dhe për të kryer veprimet nëpërmjet bankës. Qëllimi është reduktimi i *cash*-it.

Neni 12

Punonjësit e bankës detyrohen të ruajnë konfidencialitetin e procesit të raportimit, lidhur me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit dhe ndalohen të njoftojnë klientin për procedurat e verifikimit të dyshimit dhe për raportimin e bërë tek autoriteti përgjegjës.

KËRKESA MBIKËQYRËSE

Neni 13

13.1 Banka e Shqipërisë, në ushtrimin e rolit mbikëqyrës të sistemit bankar, kontrollon zbatimin nga ana e bankave të ligjit "Për parandalimin e pastrimit të parave" dhe të kësaj rregulloreje.

13.2 Banka e Shqipërisë raporton tek autoriteti përgjegjës edhe rastet që i vëren si të dyshimta gjatë ushtrimit të mbikëqyrjes bankare.

13.3 Banka e Shqipërisë vlerëson mjaftueshmërinë e programeve dhe të sistemit të kontrollit të brendshëm të bankës për parandalimin e pastrimit të parave.

Neni 14

14.1 Për të gjitha shkeljet e evidentuara nga Banka e Shqipërisë, të cilat janë objekt ndëshkimi nga autoriteti përgjegjës, Banka e Shqipërisë informon këtë të fundit duke i vënë në dispozicion dokumentacionin e plotë të konstatimit të shkeljes. Ajo mund të njoftojë që në moment autoritetin përgjegjës për konstatimin e shkeljes dhe të veprojnë bashkërisht.

14.2. Për të gjitha shkeljet e evidentuara nga Banka e Shqipërisë, në rast se ato nuk janë objekt dënimi dhe masash ndëshkimore nga autoriteti përgjegjës, Banka e Shqipërisë vendos dënime ose masa ndëshkimore, në përputhje me nenin 44 të ligjit nr.8365, datë 2.7.1998 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

14.3. Banka e Shqipërisë zgjedh dhe emëron likuidatorin e bankës, si dhe revokon licencën e saj, në rast se ka prova të besueshme që administratorët e bankës janë përfshirë në transaksione të jashtëligjshme, si pastrim parash dhe /ose financim i terrorizmit, kanë kryer mashtrime të rënda ose kanë përfituar personalisht dhe i kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme bankës ose personave të tretë.

Neni 15

Udhëzimi "Për parandalimin e pastrimit të parave", miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.102, datë 29.12.2001, shfuqizohet në momentin e hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

Neni 16

Kjo rregullore, së bashku me anekset 1 dhe 2 bashkëlidhur, u miratua me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.10, datë 25.2.2004 dhe hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Shkëlqim Cani

ANEKS 1
Transaksione të dyshimta

Bankat, nga shqyrtimi i plotë i të gjitha elementeve në dispozicion të tyre, vlerësojnë operacionet me qëllim sinjalizimi tek autoriteti përgjegjës për një llogari apo transaksion të dyshimtë. Vlerësimi bëhet nga peshimi i të dhënave, që krijojnë te një subjekt i kujdesshëm profesionalisht dyshimin për një prejardhje të paligjshme të parasë, të pasurive ose të të mirave materiale, objekt i operacionit ose i përdorimit të tyre për të mbështetur, për të nxitur ose për të fshehur aktet terroriste ose financimin e terrorizmit.

Operacione që shfaqen me anomali objektive mund të rezultojnë të justifikuara dhe të padyshimta, nëse shihen nën dritën e të dhënave të njohura nga banka.

Lista e mëposhtme përmbledh një numër operacionesh që duhet të trajtohen me kujdes nga banka, pasi mund të jenë operacione të dyshimta, por ajo nuk është përfundimtare, vetëm do të shërbejë si orientuese.

1. Tregues të anomalisë në operacionet që u drejtohen të gjitha bankave

1.1 Operacione që, në lidhje me subjektin që i vë në jetë, shfaqen me një vlerë jo të zakontë ose ekonomikisht të pajustifikueshme.

1.2 Operacione të së njëjtës natyrë, të përsëritura pranë së njëjtës degë ose të njëjtës agjenci, në mënyrë të tillë që të bëjnë të dyshosh për synime të paligjshme.

1.3 Operacione të kryera vazhdimisht në emër të të tretëve, që nuk shfaqen asnjëherë personalisht në bankë, kur kjo nuk rrjedh nga kërkesa operative ose organizative evidente të klientit, veçanërisht kur jepen justifikime që nuk mund të ballafaqohen (për shembull sëmundje, punë etj.).

1.4 Operacione për të cilat të dhënat janë në mënyrë të dukshme të pasakta ose të paplota, ose të tilla që të bëjnë të dyshosh se synojnë të fshehin me dashje informacione thelbësore, në veçanti që u përkasin subjekteve të interesuara për operacionin.

1.5 Operacionet me personat e lidhur me bankën.

1.6 Transaksione komplekse, të pazakonta dhe në shuma të mëdha.

1.7 Transaksione me banka të huaja në vende me parajsë bankare ose financiare, me vende që lejojnë çeljen e llogarive anonime ose që legjislacioni i të cilave nuk konsideron dhe klasifikon si vepër penale për pastrim parash, veprën penale nga e cila kanë rrjedhur paratë ose pasuritë.

1.8 Transaksione me shoqëri të njohura si "Off shore", me persona të implikuar në listat e shpallura si financues të terrorizmit, me kompani e persona të përfshirë në skandale financiare ose në krime të tjera të rënda.

2. Tregues të anomalisë në operacionet në *cash*.

2.1 Kërkesa të shpeshta dhe për shuma të mëdha të çeqeve kundrejt derdhjeve në *cash*.

2.2 Tërheqje ose derdhje të mëdha në *cash*, të pamotivuara nga aktiviteti i klientit (veçanërisht, kur shumat e derdhura transferohen më pas, brenda një intervali të shkurtër kohe ose me të dhëna apo destinacione që nuk lidhen me aktivitetin normal të klientit).

2.3 Përdorimi i shpeshtë i *cash*-it në shuma të mëdha për kryerjen e urdhërxhirimeve (në dobi të të tretëve), pa arsye të pranueshme, që lidhen me aktivitetin normal të klientit, veçanërisht nëse operacioni kryhet jashtë vendit.

2.4 Derdhje të shpeshta në *cash*, të kryera në mënyrë të tillë që vlefta e operacioneve të veçanta të kalojë pa u vënë re, ndërsa ajo e përgjithshme rezulton e konsiderueshme (për shembull derdhje të pjesshme në disa llogari).

2.5 Kryerja e operacioneve si derdhje, ashtu edhe tërheqje, të bëra në *cash*, të ndryshme nga

instrumentet e mjetet e pagesës zakonisht të përdorura në aktivitetin ekonomik të ushtruar nga klienti.

2.6 Operacione të shpeshta këmbimi në *cash*, në valuta të tjera për shuma të konsiderueshme, veçanërisht nëse kryhen pa kaluar në llogarinë rrjedhëse.

2.7 Këmbime të një sasie të madhe kartëmonedhash ose monedhash me kartëmonedha ose monedha të një prerjeje të ndryshme.

2.8 Blerje të shpeshta të shumave të mëdha të monedhave metalike dhe të kartëmonedhave me vlera commemorative për qëllime numizmatike.

2.9 Shitblerje të biletave të fitueseve të basteve, të llotarive, të biletave të kazinove, të lojërave të fatit, të lotosporteve etj.

2.10 Shitblerje të pasurive (shtëpive, veturave, pajisjeve etj.), të regjistruara mbi vlerën reale të tregut.

2.11 Bankat një vëmendje të veçantë duhet të tregojnë edhe për transaksionet dhe/ose dërgesat e parasë fizike dhe instrumente ekuivalente midis institucioneve financiare ose transaksionet midis grupeve financiare, si dhe transaksionet lidhur me organet tatimore.

3. Tregues të anomalisë në operacionet me letrat me vlerë

3.1 Blerja dhe/ose depozitimi i letrave me vlerë për shuma të mëdha, kur kjo nuk përputhet me kushtet financiare të klientit.

3.2 Arkëtimi në *cash* ose depozitimi, edhe me garanci të besueshme, i titujve të një vlefte të konsiderueshme, vendi ose të huaja, veçanërisht nëse janë me shpërndarje të kufizuar, kur operacioni duket jonormal në krahasim me karakteristikat e klientit dhe nuk jepet një justifikim i pranueshëm për prejardhjen.

3.3 Negocimi i letrave me vlerë për arkëtime në *cash* ose për blerjen e letrave me vlerë të tjera (aksione, obligacione, tituj publikë etj.) pa kaluar operacioni në llogarinë rrjedhëse që përdoret nga klienti.

4. Tregues të anomalisë në operacionet me jashtë

4.1 Transferimet, edhe elektronike, të shumave të mëdha në vlerë jashtë shtetit ose nga jashtë me urdhërpagesë në *cash*, veçanërisht kur nuk kalojnë nëpërmjet një llogarie, ose kur karakteristikat e operacionit, përfshirë këtu vendi i huaj i origjinës ose i destinacionit të shumave, nuk janë të justifikuara nga aktiviteti ekonomik i zhvilluar nga klienti ose nga rrethana të tjera.

4.2 Operacione me filiale ose me degë të institucioneve financiare, të rrethuara nga zona gjeografike të njohura si zona të trafikut të drogës ose si "qendra offshore", që nuk janë të justifikuara nga aktiviteti ekonomik që kryhet nga klienti.

4.3 Përdorimi i sistemeve të tjera financimi tregtar për të transferuar shuma mes shteteve, pa qenë transaksioni përkatës i justifikuar nga veprimtaria e zakonshme ekonomike e kryer nga klienti.

4.4 Derdhje e shpeshtë e çeqeve të udhëtarëve, e letrave me vlerë ose e instrumenteve të tjera financiare në valutë të huaj, pa justifikime të arsyeshme.

4.5 Kryerje e disa transfertave në një drejtim të caktuar, transferta të ndryshme që kanë një përfitues, pavarësisht nga shuma.

5. Tregues të anomalisë në operacione e shërbime të tjera

5.1 Përdorim i përsëritur i kasetave të sigurimit ose i shërbimeve të ruajtjes, ose depozitime të shpeshta dhe tërheqje të plikove të vulosura, të pajustifikuara nga aktiviteti dhe zakoni i klientit.

5.2 Delegimi për të operuar me kasetat e sigurimit te të tretët, që nuk bëjnë pjesë në bërthamën familjare të mbajtësve ose që nuk janë të lidhur me raporte bashkëpunimi ose të një tipi tjetër, që do të justifikonte këtë delegim.

5.3 Dhënia e garancive nga ana e të tretëve, joklientë të bankës, as dhe të njohur ndryshe, te të cilat nuk jepen të dhëna të mjaftueshme për marrëdhëniet me klientin përfitues të besimit apo arsye që justifikojnë dhënien e një garancie të tillë.

5.4 Blerja ose shitja e sasive të mëdha të monedhave, të metaleve të çmuara ose të vlerave të tjera, pa një justifikim të dukshëm dhe/ose në përputhje me kushtet ekonomike të klientit.

5.5 Kërkesa që i bëhet bankës, nga ana e një klienti, për të dhënë një financim për një subjekt tjetër për të cilin vetë klienti ofron një garanci reale (për shembull pasuri të paluajtshme ose letra me vlerë) në rast se marrëdhëniet midis klientit të dhënë dhe subjektit tjetër nuk janë të justifikuara.

6. Tregues të anomalisë në ecurinë e llogarive

6.1 Llogari të përdorura jo për operacione normale personale ose aktivitete ekonomike të

lidhura me to, por për të marrë ose për të derdhur shuma të mëdha që, në bazë të elementeve në dispozicion, nuk gjejnë justifikim ose lidhje me mbajtësin e llogarisë dhe/ose me aktivitetin e tij.

6.2 Llogari që për një kohë të gjatë janë joaktive ose pak të aktivizuara dhe pa justifikime të arsyeshme, papritmas fillojnë operacione me shuma të mëdha ose që pak kohë më parë kanë përfituar kreditime të mëdha e të papritura, sidomos nëse ato vijnë nga jashtë.

6.3 Llogari që paraqesin një tepricë aktive të madhe, që nuk përputhet me ecurinë e zakonshme financiare të klientit, veçanërisht nëse ajo është transferuar në llogari jashtë shtetit.

6.4 Llogari që përfitojnë një numër të madh derdhjesh për shuma të marra pa justifikime të arsyeshme.

6.5 Llogari që tregojnë një lëvizje të pajustifikuar nga aktiviteti i zhvilluar prej klientit (për shembull derdhje të shpeshta të çeqeve, veçanërisht kur në to figurojnë elemente përsëritëse nga ana e një subjekti, që nuk ushtron aktivitetin e dhënies së financimeve).

6.6 Konfigurimi, ekonomikisht jonormal, i raporteve që mbahen nga klienti me bankën, për shembull llogari të shumta të hapura pa justifikim pranë së njëjtës bankë, transferime të shpeshta shumash mes llogarive të ndryshme ose barazimi në një kohë të shkurtër mes derdhjeve e tërheqjeve në *cash* mbi të njëjtën llogari ose depozitë, pranimi i vetëdijshëm i kushteve e taksave të pafavorshme dhe që nuk përputhen me ato të tregut.

6.7 Klienti mund të hapë disa llogari dhe kryen transferta të shpeshta të fondeve midis tyre.

7. Tregues anomalie në sjelljen e klientelës

7.1 Klientë që kërkojnë të ristrukturojnë operacionin, kur konfiguracioni i paraqitur që në fillim implikon forma identifikimi e regjistrimi ose plotësime hetimesh apo verifikimesh nga ana e personelit të ndërmjetësuesit, ose adoptimi i klauzolave kufizuese të lirisë së qarkullimit të titujve (për shembull reduktimi i vleftës së operacionit nën 2 milionë lekë ose ekuivalentet në monedha të tjera për të shmangur identifikimin).

7.2 Klientë që refuzojnë ose që pa justifikim ngurrojnë të japin informacionet e duhura për kryerjen e operacioneve, të deklarojnë aktivitetet e veta, të paraqesin dokumentacionin kontabël ose të një lloji tjetër, të sinjalizojnë marrëdhëniet e mbajtura me bankat e tjera, të japin informacione që, në rrethana normale, do ta bënin vetë klientin të përshtatshëm për të marrë kredinë ose shërbime të tjera bankare.

7.3 Klientë në vështirësi ekonomike, që papritur kërkojnë të shlyejnë plotësisht ose pjesërisht detyrimet e veta me anë të derdhjeve të papritura me një vleftë të madhe, pa një justifikim të dukshëm dhe pa saktësuar origjinën e fondeve.

7.4 Klientë që evitojnë kontakte direkte me personelin e bankës, duke lëshuar prokura në emër të të tretëve, në mënyrë të shpeshtë e të pajustifikuar.

7.5 Klientë që pa justifikim kanë llogari të shumta dhe kryejnë transaksione të shumave të mëdha në *cash* mbi secilën prej tyre ose që rezultojnë të kenë, pa shkaqe të arsyeshme, llogari të hapura me shumë institucione financiare në të njëjtën zonë.

7.6 Klientë që, pa dhënë justifikime të arsyeshme, drejtohen te një sportel bankar, që ndodhet larg nga zona në të cilën banojnë ose ushtrojnë aktivitetin e tyre.

7.7 Klientë që këmbëngulin të mbajnë llogari, që duken se administrohen për llogari të të tretëve (llogari në mirëbesim), (për shembull llogari që paraqesin lëvizje që nuk lidhen me aktivitetin e zhvilluar nga mbajtësi i llogarisë ose të një vlefte që nuk i korrespondon vëllimit të tij të punës, ose llogari të emërtuara në favor të administratorëve, të vartësve ose të klientëve, të përdorura nga sipërmarrje ose ente për të kryer derdhje ose tërheqje në *cash* ose nëpërmjet instrumenteve të tjera financiare).

7.8 Klientë ose përfaqësues të tyre që paraqesin dokumente identifikimi me origjinë të dyshimtë.

7.9 Klientë që publikisht njihen që kanë të dhëna kriminale.

7.10. Klientë që japin si adresë të tyre një adresë të një personi të tretë.

7.11 Klientë që kryejnë transaksione me partnerë jo të zakonshëm.

7.12 Mosjustifikimi me dokumentacion përkatës i veprimeve të kryera nga jorezidentët me llogaritë e hapura pranë bankave.

8. Anomalitë lidhur me veprimet me letrat me vlerë të qeverisë nga persona fizikë

8.1 Blerje të shpeshta të vëllimeve të mëdha të letrave me vlerë të qeverisë.

8.2 Transferta në vlera më të mëdha se zakonisht, më të shpeshta ose jo tipike të letrave me vlerë të qeverisë, të përfituara nëpërmjet Bankës së Shqipërisë, të kryera nga një ose disa persona fizikë.

8.3 Blerja dhe menjëherë pas kësaj ofrimi për shitje i letrave me vlerë të qeverisë para maturitetit, të përfituara nëpërmjet Bankës së Shqipërisë, në madhësi të mëdha dhe në rrethana që duken jo të zakonshme për mënyrat normale të kryerjes së këtij aktiviteti.

8.4 Madhësi në vëllime të mëdha dhe të përsëritura të tregtimeve jonormale të letrave me vlerë të qeverisë për llogari dhe me shpenzime të një pale të tretë, kundrejt paraqitjes së një prokure ose në emër të personave nën 18 vjeç.

9. Pastrimi i parave nëpërmjet përfshirjes së punonjësve të bankës

9.1. Një ndryshim i madh në kushtet e jetesës së një punonjësi të bankës i pamotivuar: menjëherë një mënyrë luksi jetese.

9.2. Një ndryshim në kryerjen e detyrave, si rritje e menjëhershme e madhësisë së transaksioneve në *cash*.

10. Veprimet e zyrave të këmbimit valutor

10.1. Në praktikën ndërkombëtare, zyrat e këmbimit valutor po përdoren gjithnjë e më shumë si rrugë për pastrimin e parave, pasi në operacionet që ato kryejnë është e vështirë të dalë i qartë burimi dhe origjina e parave që këmbehen.

10.2 Ekzistenca e tregut joformal lë shteg për veprime jo të rregullta.

ANEKS 2

Lista e transaksioneve

a) Transaksionet në llogaritë e kapitalit:

i) investimet e drejtpërdrejta;

ii) veprimet me letra me vlerë;

iii) transaksionet e kreditit;

iv) transaksionet e depozitave ndërbankare;

v) transaksionet e sigurimit jashtë territorit dhe jashtë juridiksionit të Republikës së Shqipërisë kur këto veprime lejohen nga legjislacioni shqiptar.

b) Transferimi i kapitalit nga shtete të tjera në territorin e Republikës së Shqipërisë.

c) Transferimi i kapitalit nga territori i Republikës së Shqipërisë në shtete të tjera.

d) Transaksionet korente.

e) Transferimet e njëanshme të kapitalit:

i) transferimet personale të aktiveve;

ii) transferimet fizike të aktiveve.

f) Investimet e jorezidentëve në letrat me vlerë.

g) Llogaritë e rezidentëve jashtë vendit.

h) Llogaritë e jorezidentëve.

i) Transaksionet e pagesave me jashtë.